



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KPM-2023/03

Në mbështetje të nenit 3, paragrafi 2, nën paragrafi 2.6 dhe 2.11, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM nxjerr:

**RREGULLORE PËR PRONËSINË DHE KONCENTRIMIN E TË LICENCUARVE TË KPM-së**

**Neni 1  
Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim vendosjen e standardeve lidhur me pluralizmin dhe diversitetin mediatik dhe transparencën në pronësinë e mediave, zhvillimin dhe promovimin e lirisë së shprehjes, ruajtjen e pavarësisë editoriale dhe të drejtën e informimit objektiv, duke përcaktuar rregullat për koncentrimin e pronësisë në media, parandalimin e monopolit në tregun medial, ndalimin e dominimit dhe presionit mbi mediumet, në harmoni me legjislacionin vendor si dhe praktikat më të mira evropiane.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen ndaj të gjithë të licencuarve të KPM-së të cilët ushtrojnë aktivitete të ofrimit të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuele në Republikën e Kosovës.

**Neni 3  
Përkuqizimet**

- Ofrules i shërbimit medial** – personi fizik ose juridik i cili ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përbajtjes audiovizuale të ofruesit të shërbimit medial dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij.
- Shërbim medial audiovizual** – shërbimi i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimeve programore dhe parim kryesor i të cilit është ofrimi i programeve me qëllim që të informojnë, argëtojnë apo të edukojnë gjithë publikun përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike.
- Operator i shpërndarjes** – personi juridik i cili shpërndan shërbime mediale audio dhe audiovizuale për përdoruesit përmes rrjetit kabllor, IPTV, OTT, satelitor dhe çfarëdo forme tjeter të shpërndarjes jashtë brezit frekuencor radio-difuziv tokësor.

4. **Koncentrimi i pronësisë së mediave** – nënkupton një situatë ku një numër i vogël individësh, personash juridik ose kompanish kontrollojnë aksionet në disa ofrues të shërbimeve mediale dhe kanë kontroll (efektiv), gjë që mund të çojë në një ndikim negativ në nivelin e pluralitetit të zérave dhe opinioneve në dispozicion, dhe për këtë arsyе pluralizmi dhe diversiteti mediatik nuk sigurohet.
5. **Pluralizmi mediatik** – përcakton gjendjen e të pasurit një pluralizëm zérash, opinionesh dhe analizash mbi sistemin mediatik (pluralizëm i brendshëm) ose bashkëjetesa e llojeve të ndryshme dhe të larmishme të mediave dhe mbështetjes mediatike (pluralizëm i jashtëm).
6. **Licencë** – është leje kontraktuale e dhënë nga KPM-ja për transmetime audio, audiovizuele dhe shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale. Licenca e obligon të Licencuarin që të veprojë në pajtim me Ligjin e KPM-së dhe ligjet tjera relevante të zbatueshme në Republikën e Kosovës, rregulloret dhe udhëzimet e KPM-së si dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së.
7. **I licencuar** – nënkupton subjektin të cilit KPM-ja i ka dhënë Licencën për ofrimin e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuele dhe shpërndarjen e tyre.
8. **Pronësia** – Zotërimi i një pjese ose tërë kapitalit bazë në një të licencuar.
9. **Pronësia e huaj** – Zotërimi i një pjese ose tërë kapitalit bazë në një të licencuar nga një person fizik shtetas i huaj apo person juridik i themeluar në një shtet tjeter.
10. **Pronësia direkte** – pronar të cilët posedojnë aksione në një të licencuar që u mundësojnë atyre të ushtrojnë ndikim në funksionimin dhe vendimmarrjen strategjike në një të licencuar.
11. **Pronësia indirekte** – personat fizik me aksione përfituese të cilët zotërojnë ose kontrollojnë aksionet në një media ose në emër të të cilëve këto aksioneve mbahen, duke u mundësuar atyre që në mënyrë indirekte të ushtrojnë kontroll ose ndikim në operim dhe vendimmarrja strategjike të medias.
12. **Kanal me përbajtje gjeneralistike** – shërbim medial që përbëhet nga kategori të ndryshme të programeve duke mos u kufizuar në lajme, programe informative, edukative, programe përfëmijë dhe programe kulturore, qëllimi kryesor i të cilave është të informojnë, edukojnë dhe argëtojnë publikun.
13. **Kanal tematik** – shërbimi medial programi i të cilit përmban 70% të një lloji të caktuar programor si: informativ, edukativ, argëtues, përfëmijë, sportiv, shkencor etj.
14. **Person i afërm** – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërm mi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesë privat pasuror ose jo pasuror me zyrtarin.

**Neni 4**  
**Rregullimi i pronësisë së OSHMA-ve**

1. Një person fizik ose juridik që ka një licencë transmetimi audiovizuele me karakter gjeneralistik mund të marrë vetëm edhe një licencë transmetimi audio dhe anasjelltas.
2. Një person fizik ose juridik që ka një licencë transmetimi audiovizuele me karakter gjeneralistik mund të disponojë edhe kanale tematike, në kuadër të të cilave jo më shumë se një kanal tematik me karakter informativ.
3. Një person fizik ose juridik që ka një licencë të operatorit të rrjetit mund të marrë edhe një operator të multipleksit.
4. Një person fizik ose juridik që ka një licencë të operatorit të multipleksit mund të marrë edhe një licencë për një TV të karakterit gjeneralistik apo një radio.
5. Një OSHMA ka të drejtë të ketë aksione në një agjenci lajmesh ose kompani që e zotëron atë maksimumi 10%.
6. Personi fizik apo juridik që ka licencë të operatorit të shpërndarjes mund të ketë në pronësi (aksione në çfarëdo vlerë) maksimumi një OSHMA me karakter gjeneralistik, si edhe kanale tematike, në kuadër të të cilave jo më shumë se një kanal tematik me karakter informativ.
7. Kompanitë nga sektori i reklamave ose personat fizik të lidhur me ta (që kanë më shumë se 10% të aksioneve në kapitalin e tyre) mund të kenë në pronësi (aksione në çfarëdo vlerë) maksimumi në një OSHMA me karakter gjeneralistik.
8. Asnjë i licencuar i KPM-së apo personat fizik të lidhur me të nuk mund të përfaqësojë të licencuarit e tjerë në raport me KPM-në, përveç OSHMA-së të cilën e ka në pronësi.
9. Bashkimi ose shkrirja e dy ose më shumë ofruesve të shërbimit medial në nivel nacional ndalohet me këtë rregullore, përveç nëse këta ofrues heqin dorë prej njërsës nga licencat e transmetimit dhe nuk cenohen kushtet tjera të definuara me këtë rregullore dhe Ligjin e KPM-së.
10. Asnjë i licencuar nuk mund të transmetojë më shumë se 30% të vlerës së tregut të përgjithshëm medial të komunikimeve komerciale audiovizuale.
11. Personi fizik dhe juridik i cili ka licencë në nivel nacional nuk mund të ketë edhe një pjesë të aksioneve që tejkalojnë 10% të kapitalit në një agjenci lajmesh që zhvillon aktivitete në fushën e mediave dhe anasjelltas.
12. Kufizimeve që kanë të bëjnë me numrin e kanaleve gjeneralistike, informative e tematike si dhe integrimet diagonale të tyre (pronësi në radio dhe televizion, etj) nuk i nënshtronhet Radio Televizioni Publik i Kosovës i cili ka obligime më specifike të rregulluara me ligj të veçantë.

**Neni 5**  
**Pronësia e huaj**

1. Pronësia e huaj e një OSHMA-je lejohet vetëm në rastin e kompanive komerciale të regjistruara ligjërisht në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislatinin në fuqi.
2. Rregullat mbi koncentrimin e ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuele vlejnë edhe për personat fizik ose juridik të huaj.

**Neni 6**  
**Ndalesat për pronësinë e OSHMA-ve**

1. Licenca e transmetimit nuk i lëshohet ose nuk do të vazhdojë t'i jepet:
  - 1.1. Partisë politike, bashkësisë fetare, grupit ose organizatës e cila menaxhohet nga individi i cili mban post të zgjedhur ose është anëtar i një organi ekzekutiv të një partie politike;
  - 1.2. Personit juridik i cili menaxhohet nga një individ, i cili është i dënuar në një proces në përputhje me standardet ndërkombëtare, për krimë që kanë të bëjnë me dhunë apo mashtime, të cilat nuk i janë falur ligjërisht.
  - 1.3. Entiteteve Qeveritare, përfshirë agjencitë qeveritare, ndërmarrjeve ose entitetet të tjera në të cilat qeveria ka ndikim në kontrollin e tyre.
  - 1.4. OJQ-së apo kompanisë private që në pozitat udhëheqëse të strukturës organizative ka individë që janë zgjedhur ose emëruar në funksione të larta zyrtare në nivel qeveritar apo të ndonjë subjekti politik, me përjashtim të rasteve kur personat e tillë janë dorëheqje zyrtare nga OJQ-ja apo kompania private;
  - 1.5. Kompanisë private në të cilën pronësia e një pjese ose shumicës së aksioneve i përkasin një personi të zgjedhur ose të emëruar në funksion të lartë zyrtar qeveritar apo të ndonjë subjekti politik.
  - 1.6. Parashtruesit të kërkesës për Licencë apo të licencuarit, që në pozitat udhëheqëse të strukturës organizative ka individë që janë zgjedhur ose emëruar në funksione të larta zyrtare në nivel qeveritar apo të ndonjë subjekti politik: këto dispozitat do të zbatohen njësoj për të gjithë individët që janë të zgjedhur ose janë të emëruar në një post drejtues brenda një subjekti politik. Të njëjtët nuk mund të bartin pozita udhëheqëse në strukturën organizative të parashtruesit për kërkesë për Licencë.
  - 1.7. OJQ-së ose organizatës komerciale që në mënyrë të hapur i kushton mbështetje një subjekti politik.
  - 1.8. Të licencuarit që ka kryer shkelje të përsëritura të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, i cili është në pronësi, drejtohet ose financohet nga parashtruesi i kërkesës, mund të konsiderohet bazë e mjaftueshme për refuzim të Licencës së KPM-së, të re ose të

transferuar apo për aprovinin për marrjen e një pjese të pronësisë. Shkelje të tilla merren si fakte të dështimit të vënies në funksion të një ofruesi të shërbimit medial audio dhe audiovizuel në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.

- 1.9. OJQ-së ose kompanisë private në rast se ndonjëri nga stafi udhëheqës është dënuar për shpërndarjen e materialeve që nxisin urrejtje ose diskriminim, ose që denigrojnë persona në bazë të përkatësisë etnike, origjinës kombëtare, fesë, gjinisë, orientimit seksual ose të paaftësisë fizike.
2. Dispozitat e kësaj Rregullore do të zbatohen plotësisht dhe njësoj tek çdo individ, organizatë ose kompani që vepron si person i autorizuar i një të licencuari potencial.
3. Fshehja e informacioneve të kërkua me nenin 22, paragrafi 3, të Ligjit të KPM-së dhe nenin 20 të Rregullores Nr.2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuele, të cilat po të ishin të njoitura në kohën e marrjes së vendimit do të rezultonin me refuzimin e kërkesës, mund të kenë si pasojë diskualifikimin përmarrje të Licencës ose ndërprerjen e Licencës së KPM-së.
4. Çdo ndryshim në gjendjen e zyrtarëve të OJQ-ve ose pronarëve të kompanive që zotërojnë Licencë të KPM-së ose një pjesë të pronësisë, që ka si pasojë diskualifikimin e tyre përmarrje, duhet t'i raportohet KPM-së brenda pesë (5) ditëve të punës nga ndryshimi i gjendjes. Një individ i diskualifikuar mund të shkëputet vetë nga i licencuari brenda 30 ditëve nga koha kur ka arritur në pozitë përmarrje diskualifikim, përvèç rastit kur KPM-ja lejon një periudhë më të gjatë përmarrje përmarrje diskualifikim. KPM-ja do të kërkojë në këto raste të minimizojë rrezikun e çrrëgullimit të operimit të shërbyesit medial audiovizuel.

#### **Neni 7** **Personat e lidhur me OSHMA-të**

1. Ndalesat e përcaktuara në këtë Rregullore për pronarët e një ofruesi medial audio ose audiovizuel vlefshen edhe për personat e lidhur me ta, siç janë:
  - 1.1. Bashkëshortët, të afërmit e gjakut, në vijë të drejtpërdrejt (fëmijët dhe prindërit e tyre, vëllezërit dhe motrat), si dhe adoptuesit dhe të adoptuarit;
  - 1.2. Të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt;
  - 1.3. Personat nga bashkësia martesore ose jashtëmartesore;
  - 1.4. Anëtarët e familjes së ngushtët të bashkëshortit/es;
  - 1.5. Personat të cilët mbajnë një pjesë të përgjithshme të biznesit, aksione ose të drejta të tjera në bazë të të cilave ata marrin pjesë në menaxhimin e një OSHMA-je;
  - 1.6. Personat të cilët janë anëtarë të bordit drejtues ose mbikëqyrës në një OSHMA si dhe personat që konsiderohen të janë të lidhur me kryetarët e drejtorisë ose bordit mbikëqyrës të asaj OSHMA-je.

**Neni 8**  
**Kërkesat lidhur me transparencën e të licencuarve**

1. I licencuari obligohet që paraprakisht për çfarëdo ndryshimi të pronësisë dhe/ose aksioneve duhet të merr aprovim paraprak me shkrim nga KPM-ja.
2. Në raport me transparencën e të licencuarve minimalisht duhet të raportohen në KPM këto të dhëna:
  - 2.1. Emri dhe detajet e kontaktit të pronarit apo pronarëve të drejtpërdrejtë me aksionet që u mundësojnë atyre të ushtrojnë ndikim në funksionimin dhe vendimmarjen strategjike të medias, si dhe pronarët indirekt, aksionet indirekte dhe proporcionet e të drejtave të votimit;
  - 2.2. Adresa e banimit ose zyrës së regjistruar;
  - 2.3. Emrat e personave me përgjegjësi ekzekutive;
  - 2.4 Emrat e personave të autorizuar të përfaqësojnë kompaninë;
  - 2.5 Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës, nëse ka të tillë;
  - 2.6 Nëse pronari është një kompani tjeter, atëherë të njëjtat të dhëna duhet shpalosur edhe për atë kompani dhe për gjithë strukturën e pronësisë deri në pronarin e fundit
3. Të dhënat nga paragrafi më lartë, përveç nga KPM, njëkohësisht duhet të publikohen edhe në uebfaqen zyrtare të të licencuarve.
4. I licencuari obligohet që brenda pesë (5) ditëve të punës të informojë KPM-në për çdo ndryshim të të dhënavë të paraqitura në KPM, duke përfshirë:
  - 4.1. Çdo ndryshim në strukturën organizative, përfshirë menaxhmentin e lartë, drejtorin e subjektit, emrat e personave që kanë përgjegjësi editoriale;
  - 4.2. Të dhënat e adresës së të licencuarit, telefonit, postës elektronike ose informacione të tjera kontakti;
  - 4.3. Ndryshimet më shumë se 30% të burimeve të financimit, të përcaktuara në formën e kërkesës për raportim të KPM-së sipas nenit 28 të Ligjit për KPM-në.
5. Të licencuarit do të deponojnë njëherë në vit report me të dhëna për aspekte të pronësisë, strukturës organizative, programore dhe financiare.

**Neni 9**  
**Sanksionet**

Për mosrespektim të kësaj Rregulloreje do të aplikohen sanksionet e përcaktuara me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave.

**Neni 10**  
**Dispozitat kalimtare**

1. Të licencuarit janë të obliguar që në afat prej tre (3) muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje të ofrojnë informacionet e këruara sipas nenit 8, paragrafi 1, 2 dhe 3, të kësaj Rregulloreje.
2. Të gjitha licencat e lëshuara nga KPM-ja në pajtim me legjisacionin e mëparshëm do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në datën e skadimit të tyre të rregullt.
3. Të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me ripërtëritjen e licencave dhe ndryshimet në pronësi të parashtruara para hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, do të trajtohen sipas legjisacionit i cili ka qenë në fuqi deri në momentin e parashtrimit të këtyre kërkesave.

**Neni 11**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit.

  
\_\_\_\_\_  
**Jeton Mehmeti**  
**Kryetar**  
**Komisioni i Pavarur i Mediave**



21.12.2023  
**Datë**